



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2022:212979
Datë: 22.05.2024
Numri i dokumentit: 05722486

C.nr.2095/23

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, Gjyqtari Durim BALAJ, me bashkëpunëtorin profesional Zef Qupi, në çështjen kontestimore të paditësit A.P., nga Gjakova, të cilin e përfaqëson Ylli Bokshi avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson i autorizuari V.Rr., për kompensimin e shpenzimeve të ushqimit në punë, pas përfundimit të shqyrtimit kryesor – publik, në të cilin prezantuan të autorizuarit e palëve ndërgjyqëse, me 22 maj 2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET në tërësi e bazuar kërkesëpadia e paditësit A.P., nga Gjakova dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, që paditësit në emër të kompensimit të ushqimit për ditët e pranisë në punë, respektivisht për 216 ditë pune, dhe atë për periudhën nga data 01.03.2020 e deri me datë 31.05.2021, t'ia paguajë shumën prej 432,00 euro, me kamatë prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 17.10.2022 (data e paraqitjes së padisë), e deri në pagesën definitive, në afatin prej 7 ditëve, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës që paditësve, në emër të shpenzimeve të procedurës, të i'u paguaj shumën prej 199.40 euro, në afatin prej 7 ditëve nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.

A r s y e t i m

Paditësi në padinë e parashtruar në këtë gjykatë me datë 17.10.2022, përmes të autorizuarit të tij, ka parashtruar se sipas kontratës kolektive sektoriale të arsimit në Kosovë, konkretisht nenit 35 paragrafi 7, është paraparë kompensimi për ushqim gjatë punës, për të gjithë punonjësit që kanë marrëdhënie të punës në institucionet arsimore. Kanë theksuar se nga koha e hyrjes në fuqi të kontratës kolektive e deri me tani, dispozita e nenit 35 paragrafi 7 nuk është realizuar për periudhën prej 31.08.2020 deri me 31.05.2021, kështu duke bërë që kontrata kolektive të mos ekzekutohet në tersi.

I autorizuari i paditësit gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare deklaron se qëndronë pranë padisë dhe kërkesëpadisë sa i përket kompensimit të shujtave ditore. Po ashtu deklaron se pas administrimit të provave, kërkesëpadia e paditësit, u vërtetua si për nga baza ashtu edhe nga lartësia e saj, andaj i propozojmë gjykatës që e njëjta të aprovohet në tërësi si e bazuar.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë: Shumën prej 20,00 euro e cila referohet taksës gjyqësore të paguar për padi, shumën prej 78,00 euro. e cila shumë i referohet përpilimit të padisë, shumën prej 101,40 euro, përkatësisht shumën e përgjithshme 199,40 euro

I autorizuari i të paditurës në përgjigje në padi, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e kundërshton në tersi kërkesëpadinë e paditësit si dhe pas administrimit të provave u vërtetua pabazueshmeria e kërkesëpadisë së paditësit. Ka shtuar se edhe më tej mbetem pranë parashtrimeve që i kam dhënë më herët, duke i propozuar gjykatës që kërkesëpadia e paditësve të refuzohet në tërësi si e pa bazuar.

Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Me qëllim të vlerësimit të drejtë dhe vërtetimit të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, në shqyrtimin kryesor-publik, gjykata bëri administrimin e provave dhe atë: Kontratë e punës, me nr.DA-04-21, datë 24.03.2016, e lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës, Vendimi nr.01 nr. 112-27235 i datës 15.04.2024, Kërkesë e paditësit e datës 18.05.2022, Përgjigja në Kërkesë e datës 05.08.2022, Vërtetimi për ditët e prezencës në punë me nr.54-2/2021 i datës 22.06.2022.

Gjykata pas vlerësimit të secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku, e mbështetur në dispozitat nga neni 8 i Ligjit për Procedurën Kontestimore, arriti në përfundimin se kërkesëpadia e paditësve është e themeltë dhe si e tillë u aprovua.

Nga provat e administruara, është vërtetuar gjendja faktike si në vijim:

Nga Kontratë e punës, me nr.DA-04-21, datë 24.03.2016, e lidhur në mes të paditësit dhe të paditurës, vërtetohet se paditësi është në marrëdhënie pune me të paditurën nga data 24.03.2016.

Nga Vendimi nr.01 nr. 112-27235 i datës 15.04.2024, vërtetohet se paditësit është zgjedhur Drejtor në SHMU “....” në Gjakovë për një mandat 4 vjeçar.

Nga Kërkesë e paditësit e datës 18.05.2022, vërtetohet se paditësi ka kërkuar nga e paditura kompensimin e shujtës ditore dhe atë duke u bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit.

Nga Përgjigja në Kërkesë e datës 05.08.2022, vërtetohet se të paditurit ju është refuzuar kërkesa për kompensimin e shujtës ditore për gjithsej 216 ditë.

Nga Vërtetimi për ditët e prezencës në punë me nr.54-2/2021 i datës 22.06.2022, vërtetohet se paditësi nga data 01.03.2020 deri me 31.08.2020 ka vijuar 31 dit pune dhe nga data 01.09.2020 deri me 31.05.2021 ka vijuar 185 dit pune tek e paditura.

Gjykata duke u bazuar në dispozitën ligjore të nenit 35 par. 7 të Kontratës Kolektive të Arsimit Parauniversitar, datë 18.04.2017 si dhe kontratën e datës 22.01.2021, në të cilat në mënyrë të njëjtë është paraparë se: *“Të punësuarve iu njihet e drejta për ushqim gjatë punës për ditët e pranisë në punë, vlera e kompensimit të ushqimit për një ditë të pranisë në punë, është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënie primare të punës në institucionet arsimore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restaurantit apo kuzhinës, apo ndonjë forme tjetër nuk e ka obligim, për t’a bërë kompensimin”,* e duke pasur parasysh faktin se e paditura nuk ka argumentuar (me asnjë provë materiale, faktin se e ka të rregulluar çështjen e ushqimit të të punësuarve (në vend punimin – objektin ku kanë punuar këtu paditësit), si dhe duke pasur parasysh faktin se Kontratat e elaboruara më sipër, është vërtetuar fakti se paditësi është në marrëdhënie pune në SHFMU “Mazllum Këpuska” në Gjakovë, ndërsa vërtetimet mbi ditët e prezencës në punë për paditësin e lartcekur, të lëshuar nga shkolla

përkatëse në të cilat janë specifikuar saktë ditët e prezencës në punë të paditësit, erdhi në përfundim se kërkesa e paditësit për një kompensim të këtyllë është e themelte, andaj edhe ju aprovua sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Sipas nenit 8 paragrafi 1, të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të Kosovës (Ligji nr. 04/L-077) është paraparë se: *“Pjesëmarrësit në marrëdhënien e detyrimit kanë për detyrë ta përmbushin detyrimin e vet dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tij”*. Për më tepër dispozita e nenit 245 paragrafi 1 të LMD-së, ka paraparë se: *“Kreditori në marrëdhënien e detyrimit ka të drejtë që prej debitorit të kërkojë përmbushjen e detyrimit, ndërsa debitori ka për detyrë ta përmbushë atë me ndërgjegje dhe në tërësi, në përputhje me përmbajtjen e tij”*, prej nga rezulton se debitori, përkatësisht e paditura është e detyruar që kreditorit, përkatësisht këtu paditësit, t’ia paguajë vlerën e kërkesëpadisë të aprovuar sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kundërshtimin e të paditurës lidhur me mungesën e mjeteve buxhetore, gjykata e vlerësoj të pambështetje, pasi që zbatueshmëria e kontratave kolektive të arsimit në Kosovë, ajo e datës 18.04.2017, si dhe e datës 22.01.2021, është paraparë saktësisht në nenin 2 të tyre, andaj për gjykatën ky pretendim ishte jo relevant për vendosje ndryshe.

Gjykata me aktvendimin e datës 20.05.2024 e ka konstatuar të tërhequr padinë e paditësit sa i përket kërkesës lidhur me anulimin e vendimit të komisionit për ankesa për nëpunësit e shërbimit publik nr. 01-070/01-212211 të datës 28.09.2022 meqenëse i autorizuari i paditësi është tërhequr nga kjo kërkesë, për këtë gjykata ka vendosur që ta konstatoj tërhequr padinë për këtë pjesë duke u bazuar në nenin 261 par.2 të LPK-së.

Lidhur me kamatëvonesën gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 382 paragrafi 1 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u mor sipas nenit 452 paragrafi 1 të LPK-së, me ç’ rast paditësve iu pranuan shpenzimet siç në poshtë vijojnë: Shumën prej 20,00 euro e cila referohet taksës gjyqësore të paguar për padi, shumën prej 78,00 euro. e cila shumë i referohet përpilimit të padisë, shumën prej 101,40 euro, shumë kjo e cila i referohet një seance gjyqësore, përkatësisht shumën e përgjithshme prej 199.40 euro.

Nga të lartë cekurat u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.2095/23, me 22 maj 202

G J Y Q T A R

Durim BALAJ

UDHËZIM JURIDIK:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së te njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në ekzemplarë të mjaftueshëm për palët dhe gjykatën.